


№ 1625 dt 23 08 2021

 Menaxhimi Cilësisë dhe Politikave	POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT	PO-SIM-002
	ver. 1.0	faqe 1 nga 1

POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

KOSTT sh.a, është Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, një subjekt i cili luan rol të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Kosovë.

Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit i KOSTT ka për qëllim të siguroj:

1. Informatat në KOSTT në të gjitha format: të shkruar, të folur, të ruajtur në mënyrë dixhitale ose të shtypur, do të mbrohet nga modifikimi aksidental ose i qëllimshëm i paautorizuar, shkatërrimi ose zbulimi gjatë gjithë ciklit të tij të jetës. Kjo mbrojtje përfshin një nivel të duhur sigurie mbi pajisjet dhe softverët e përdorur për përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e informacionit.
2. Të gjitha politikat, procedurat, instruksionet dhe dokumentet tjera të dokumentuara në versionin final dhe të aprovuara, duhet të vihen në dispozicion për të gjithë personat përgjegjës për të siguruar konformitetin e pajtueshmëri.
3. Të gjitha aktivitetet e identifikuar në organizatë, duhet gjithashtu të dokumentohen. I gjithë dokumentacioni, i cili mund të jetë në formë dixhitale, duhet të ruhet konform procedurave të aprovuara në KOSTT I gjithë dokumentacioni duhet të rishikohet për përshtatshmëri në mënyrë periodike më së largu një herë në vit.
4. Të gjitha dokumentet që do të krijohen në të gjitha departamentet e KOSTT, do të përgatiten në përputhshmëri me këtë politikë, standardet e zbatuara dhe orientimin strategjik të organizatës. Të gjitha dokumentet në nivel të departamenteve duhet të jenë në përputhje me këtë politikë. Të gjitha sistemet e zbatuara pas datës efektive të kësaj politike pritet të jenë në përputhje me orientimin strategjik dhe dispozitat e kësaj politike.

II. FUSHËVEPRIMI

- A. Fushëveprimi i sigurisë së informacionit përfshin mbrojtjen e CIA (konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë) së informacionit të ruajtur dhe të procesuar nga KOSTT konform Standardit ISO/IEC 27001:2013.
- B. Ekipi kompetent i autorizuar për menaxhim të sigurisë së informacionit, siguron integritetin e të gjitha dokumenteve të aprovuara në KOSTT dhe mbrojtjen e CIA-s së të gjitha të dhënave tjera të përpunuara dhe të ruajtura në pajisjet e KOSTT.
- C. Përmes kësaj politike të sigurisë së informacionit, KOSTT demonstroi përkushtimin ndaj menaxhimit efektiv të gjitha informatave të brendshme dhe të jashtme në kategoritë e përcaktuara në matricën e klasifikimit të informacionit të KOSTT.

Datë: 23.08.2021

